

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe neni 20, paragrafi (1), nënparagrafi 10¹ të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 41, paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, neni 15, paragrafi (1), nënparagrafi 3 dhe neni 39, paragrafi (1), nënparagrafi 10 të Rregullores së punës së Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, duke vendosur sipas Njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë nr.9/1 datë 4.9.2023 (PA1 nr.02-306 datë 6.9.2023), në pajtim me Konkluzionin e Këshillit ark.nr.02-3506/4 datë 25.9.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 30-të mbajtur më 22.9.2023, miratoi sa vijon:

VENDIM

1. LEJOHET ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, përkatësisht:

- për largimin e personit fizik , me NVAQ dhe adresë në rrugën , dhe

- për vendosjen e personit fizik , me NVAQ dhe adresë në rrugën "

nr. .

2. Obligohet Shoqëria Tregtare Radiodifuzive RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, pas ndryshimit të përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, t'ia dorëzojë Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale gjendjen aktuale vijuese të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

Arsyetim

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, në pajtim me nenin 41, paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.171/14), me Njoftim për ndryshimin e strukturës së pronësisë nr.9/1 datë 4.9.2023 (PA1 nr.02-306 datë 6.9.2023), e njoftoi Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencinë) për qëllimin e tij për zbatim të ndryshimit në strukturën e pronësisë të SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë.

Njoftimi i dorëzuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë nr.9/1 datë 4.9.2023 (PA1 nr.02-306 datë 6.9.2023), nga SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, rezulton se është i plotë dhe i rregullt, gjegjësisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e informimit për ndryshim të strukturës së pronësisë.

Agjencia për të shqyrtuar nëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë do të krijojnë përqendrim të paligjshëm mediatik, gjegjësisht nëse janë në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LSHMAAV, përmes sistemit të shpërndarjes së internetit të Regjistrisë Qendrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV-së), siguroi (ofroi) dokument "Informacion për subjektet e ndërlidhura (persona të autorizuar, organet drejtuese, pronarë në subjekte të tjera)–Gjendja vijuese", nr.0820-50/150020230232332

¹Nënparagrafët 8 dhe 9 janë fshirë, shih: Nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.248/18).

datë 11.9.2023, nga ku rezulton se personi [REDAKTUAR] nuk figuron si themeluese apo drejtuese e shoqërive tregtare.

Gjithashtu, Agjencia ka kryer verifikim dhe në Regjistrin e Pronarëve të Vërtetë (Përfitues) i cili udhëhiqet nga Regjistri Qendror i RMV-së, nga ku ka siguruar dokumentin “Gjendja vijuese e personit fizik – pronar i vërtetë”, nr.2007-50/150020230233295 datë 12.9.2023, për [REDAKTUAR], me çka vërtetohet se ky person nuk figuron si pronar i vërtetë në asnjë shoqëri tregtare.

Pas ndryshimit të kryer të strukturës së pronësisë, pronar i vetëm i SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë do të jetë personi fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rrugën [REDAKTUAR] nr. [REDAKTUAR] Tetovë, me pjesëmarrje në kapitalin bazë prej 100%.

Duke qenë se Agjencia ka konstatuar se zbatimi i ndryshimit të strukturës së pronësisë të SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë nuk krijon koncentrim të paligjshëm mediatik në aspekt të LSHMAAV, gjegjësisht se ky ndryshim nuk është në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35. pika 2 dhe 38 nga Ligji i njëjtë, pas Njoftimit të dorëzuar për ndryshim të strukturës së pronësisë nr.9/1, datë 4.9.2023 (PA1 nr.02-306 datë 6.9.2023), Këshilli i Agjencisë, miratoi vendim si në dispozitiv.

Nr.02-306

25.09.2023

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike : Kundër këtij vendimi, radiodifuzeri nëse është i pakënaqur me vendimin, ka të drejtë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit të ngrejë padi për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.